



REPUB LIKA E KOSOVËS
Komuna Drenas/Gllogoc
Udhëheqësi i Personelit
01Nr. AM/61-39211 dt. 09/07/ /2018

Bazuar në nenin 12 ,paragrafi 4 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe në Ligjin Nr.04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve,me qëllim të ofrimit të shërbimeve të veçanta,Komuna Gllogoc/Drenas, U.D.Udhëheqëse e Personelit :

RISHPALLË KONKURSIN PUBLIK
me Marrëveshje për Shërbime të Veçanta

Për angazhim afatshkurter konform nenit 12 paragrafit 4, të Ligjit nr. 03/L-149, për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, (Marrëveshje për Shërbime të Veçanta).

Pozita: e vendit të punës:

koeficienti :

1. Inspektor i ndërtimit

7

Përshkrimi i vendit të punës :

- Inspektimi i ndërtimit, ku përfshin ngritjen, instalimin, renovimin dhe zgjerimin e ndërtesave;
- Inspektimi ndryshimi, ndërrimi i destinimit dhe rrënimin e çfarëdo ndërtese a strukture;
- Inspektimi i kushteve urbanistike – teknike (pëlqimi urbanistik);
- Inspektimi i dokumentacionit teknik (projektin e ndërtimit, lejet e ndërtimit);
- Inspektimi i lejeve të përdorimit të objekteve (pas përfundimit të fazës së ndërtimit);
- Mbikëqyrja e rrënimin të objekteve të ndërtuara pa leje;
- Nxjerr procesverbale, aktvendime për ndërprerjen e punëve;
- Bën propozim për nxjerrjen e aktvendimit për rrënim dhe konkluzës për lejimin e përmbarimit të aktvendimit;
- Ushtron fletëparaqitje për shkelje të dispozitave me të cilat bëhet kundërvajtje dhe vepër penale;
- Kryen edhe detyra tjera të parapara me ligj, rregullore dhe akte tjera nënligjore;
- Të raportoj për punën e bërë, raporte periodike, mujore, vjetore, etj.

Qëllimi i vendit të punës: Të gjitha inspektimet në leminë e inspeksionit të ndërtimit me qëllim të parandalimit të ndërtimeve pa leje, mbrojtja e pronës Komunale dhe shoqërore si dhe zbatimit të planit urbanistik dhe që të arrihet krijimi i rregullit nga lëmia e ndërtimtarisë.

Shkathtësitë e kërkuara: (kualifikimet, përvojat si dhe aftësitë dhe shkathtësitë tjera që kërkojnë për këtë vend të punës)

- Diplomë Universitare, Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës ,
- 3 vjet përvojë pune profesionale,
- Njohuri në fushën e programeve të kompjuterit ;Word, Excel, Power Point, Access,
- Aftësi komunikimi me kolegët, palët, eprorët dhe rrethin,
- Aftësi për përmbushjen e detyrave dhe punëve nën presion,

Aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë rekrutimin:

Përzgjedhja bëhet në pajtim me nenin 12 paragrafi 4 të Ligjit Nr.03/L-149 të Shërbimit Civil të Republikës së Kosovës, Ligjin Nr.04/L-077, Për Marrëdhëniet e Detyrimeve.

Në këtë konkurs zbatohet një procedurë e thjeshtuar e rekrutimit.

Konkursi mbetet i hapur 8 (tetë) ditë kalendarike, nga dita e publikimit **09/07/2018 deri më 16/07/2018**, që konsiderohet dita e fundit e mbylljes së konkursit.

Kohëzgjatja e angazhimeve është 5.5 muaj.

Vendi ku mund të merren dhe të dorëzohen aplikacionet:

Në objektin e komunës, kati i parë sporteli nr.10-12, gjatë orarit të punës.

Aplikacionit i bashkangjiten kopjet dokumentacionit për kualifikim arsimor dhe dokumentacionet e tjera të nevojshme për këtë vend pune, për të cilin konkurohet.



U.D.Udhëheqëse e Personelit

Hanumshahe Shabani
Hanumshahe Shabani